



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 879 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

**V E N D I M**

Nr. 225, datë 30.12.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të lirit nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\* , për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësi \*\*\*\*\* , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirit nga detyra, për shkak ristrukturimi,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 879 prot., datë 16.11.2020, nëpunësi \*\*\*\*\* ka ngritur disa pretendime, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirit nga detyra, për shkak ristrukturimi të institucionit.

Nga verifikimi i kryer për këtë rast, rezulton e vërtetuar se punonjësi \*\*\*\*\* , është nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e inspektimit të ujërave” në ISHMPU Kukës, detyrë të cilën e ka kryer deri në momentin e riorganizimit të këtij shërbimi, nëpërmjet Vendimeve nr. 568, 569, 570 e 571, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për

*krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”; “Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit”; “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve” dhe “Për Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”.*

Në kuadër të implementimit të akteve të mësipërme, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit (ISHMPUT) kaloi në proces ristrukturimi, i cili është karakterizuar nga pakësimi i njësive organizative dhe bashkimi ose shkrija e tyre, duke u shoqëruar kjo edhe me ndryshime të përshkrimit të pozicioneve të punës dhe sidomos të kërkesave të veçanta për këto pozicione të mbetura, apo krijuar rishtas.

Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me këtë rast, ka analizuar të gjithë pozicionet e punës në strukturën dhe organikën e ISHMPUT, si dhe ato të agjencive të reja të krijuara për çdo nëpunës të prekur nga ky proces ristrukturimi, duke mbajtur parasysh dispozitat e Kreut II, pika 18, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar; të Kreut II, pika 19, të aktit nënligjor të sipërcituar, siç janë: a) vjetërsia e nëpunësit civil në shërbimin civil; b) vlerësimet e rezultateve në punë dhe c) vlerësimi i fundit që ka pasur nëpunësi në testimin për përfitimin dhe për përditësimin e njohurive shtesë dhe dispozitat e udhëzimit të DAP nr. 1, datë 01.03.2016 “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Pas kryerjes së procesit si më sipër, Komisioni i Ristrukturimit ka konstatuar se në ish ISHMPU Kukës, ka shkurtrim të dukshëm të pozicioneve të mëparshme të punës, ku përfshihet edhe pozicioni “*Inspektor në Sektorin e inspektimit të ujërave*”, ku ishte i punësuar nëpunësi \*\*\*\*\*. Ndodhur në këto kushte, është shqyrtuar mundësia e sistemimit të tij në institucione të tjera të shërbimit civil, duke iu referuar listës së vendeve vakante në rrethin e Kukësit, të paraqitura nga Departamenti i Administratës Publike dhe është arritur në përfundimin se: nuk ka vende vakante të së njejtës kategori në institucione të tjera të shërbimit civil në rrethin e Kukësit, në të cilat nëpunësi në fjalë plotëson kriteret e veçanta, për faktin se institucionet e shërbimit civil të këtij rrethi kanë një numër shumë të limituar të vendeve vakante.

Meqënëse nuk është arritur të gjendet një zgjidhje, Komisioni i Ristrukturimit, me vendimin nr. 5176/8 prot., datë 21.10.2020, ka paraqitur përpara njësisë përgjegjëse propozimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës, duke parashikuar edhe përfitimet që rrjedhin nga dispozitat e nenit 50, pikat 7 e 8, dhe nenit 66, pika 1, shkronja a/1, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

**Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së aktit të lirimimit nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi, të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe meqënëse nuk u gjenden elementë paligjshmërie, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**